



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Reathanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

Në këtë buletin do të gjeni:

Takimi i Tetë i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin mbi Rregjistrin e Shkarkimeve të Transferimit të Ndotësve (PRTR)

Fushata ndërgjegjësuese për një menaxhim më të mirë të mbetjeve

Faqe 1

Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pjesë e Rrjetit European të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (EIONET), Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA)

Faqe 2

Përparësitë e aplikimit on-line për procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rëndësia e monitorimit të cilësisë së ujërave

Faqe 3

Synimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit

Teknologjitë më të Mira të Disponueshme

Faqe 4

Monitorimi i zhurmave urbane

Aktiviteti njerëzor dhe performanca mjedisore

Takime me Agjencinë Suedeze të Kimikateve

Faqe 5

Inspektimi dhe Kontrolli Mjedisor

Faqe 6

Përfshirja e vetëmonitorimit në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis


Mbështetja e AKM në zbatimin e Projektit IPARD-II

Faqe 7

Takimi i Tetë i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin mbi Rregjistrin e Shkarkimeve të Transferimit të Ndotësve (PRTR),

Gjate datave 16-18 Dhjetor 2020 u mbajt takimi i Tetë i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin mbi Rregjistrin e Shkarkimeve të Transferimit të Ndotësve (PRTR), në të cilën mori pjesë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit si Pikë Fokale për Shqipërinë. Gjatë këtyre diteve u shqyrtuan çështjet si mëposhtë:

- Statusi i ratifikimit të Protokollit për Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve.
- Promovimi dhe koordinimi global i Protokollit dhe Mekanizmat dhe sinergjitë e koordinimit;
- Pajtueshmëria dhe mekanizmat e raportimit.
- Zhvillimi i Protokollit
- Zbatimi i programit të punës për 2018-2021, përfshirë çështjet financiar



- Përgatitjet për sesionin e katërt të Takimit të Palëve të Protokollit;
- Aktivitetet nën-rajonale dhe kombëtare: arritjet, nevojat dhe sfidat për ndërtimin e kapaciteteve

Në pikën 9 të axhendës së takimit e cila ishte e fokusuar në çështje të rëndësishme të nevojave dhe sfidave për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR), Agjencia Kombëtare e Mjedisit prezantoi përvojën e vendit në këtë drejtim sëbashku me Turqinë, Kolumbinë dhe Bjellorusinë.

Gjatë këtij sesioni, të katër vendet pjesëmarrëse ndanë përvojat e fituara përmes zbatimit dhe zhvillimit të PRTR-ve në vendet e tyre si dhe si të përdorin sinergjitë me detyrimet e tjera të raportimit, në mënyrë që të përmirësojnë efektivitetin e zbatimit të PRTR-ve. Statusi aktual i PRTR si dhe aktivitetet e planifikuara në të ardhmen (planet e punës, hartat), zgjidhjet e mundshme / praktikat e mira.

Fushata ndërgjegjëse për një menaxhim më të mirë të mbetjeve

Ndërgjegjësimi mjedisor ka një rol efektiv në krijimin e vetëdijes njerëzore për mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë. Përgatit individin që të bëhet i aftë të balancojë nevojat e tij jetësore dhe mjedisin natyror. Rrit aftësinë njerëzore për të marrë pjesë në menaxhimin e mjedisit dhe në zgjidhjen e sfidave mjedisore. Ne kemi nevojë për vetëdije në sjelljen tonë për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me mbështetjen e projektit të GIZ “Menaxhimi i Modernizuar i Mbetjeve të Ngurta dhe Ekonomia Ricikluese në Respekt të Mjedisit”, ka ndërmarrë zhvillimin e një fushate ndërgjegjëse në 61 bashkitë e vendit tonë për menaxhimin e mbetjeve. Deri tani janë organizuar aktivitete ndërgjegjëse në 45 bashki ku është diskutuar për rëndësinë e ndarjes të mbetjeve që në burim.



Detyrimin që kanë bashkitë për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për hedhjen e mbetjeve të familjeve dhe bizneseve në kazanat për mbetjet e diferencuara për riciklim, kosha rrugorë, mjetet për mbledhjen dhe transferimin e tyre në vend-depozitime sanitare në mbrojtje të shëndetit të njerezve dhe mjedisit.. Nxitjen e qytetarëve dhe të bizneseve për hedhjen e rregullt dhe të diferencuar të mbetjeve, parandalimin e konsumit të produkteve plastike njëpërdorimshe, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve për të patur një mirëmenaxhim të tyre dhe mjedis të pastër

Pjesë e kësaj fushate janë dhe shkollat 9- vjeçare në bashkitë përkatëse, ku zhvillohen orë edukative për informimin e fëmijëve në lidhje me hedhjen e rregullt të mbetjeve në vendet e caktuara nga bashkia. Ndarjen e mbetjeve sipas rrymave, duke përmendur mbetjet e plastikës, letrës, kartonit. Reduktimin e përdorimit të artikujve njëpërdorimshe të plastikës si dhe riciklimin e ripërdorimit të tyre. Gjatë aktiviteteve sensibilizuese, nxënësit e shkollave kanë paraqitur vizatime, poster dhe punime të realizuara me materiale të riciklueshme. Punimet e realizuara nga nxënësit tregojnë se sa vlerë kanë mbetjet kur menaxhohen në mënyrën e duhur.



Në bashkëpunim me projektin e GIZ , në disa shkolla të përzgjedhura (7 shkolla) janë zhvilluar orë mësimore dhe trajnuese për mësuesit ku përcillen mesazhet ndërgjegjësuese për mbajtjen pastër të qytetit. Gjatë zhvillimit të mësimit tregohen disa mënyra se si mund të realizohen punime me materiale të plastikës, që të mos përfundojnë në landfille, duke ju rritur kështu jetëgjatësinë e tyre. Nga projekti i GIZ në këto shkolla janë dhuruar disa sete me materiale shkollore për krijimin e punimeve me materiale të plastikës



Nxitja e brezave të rinj për promovimin e ideve të tyre për ripërdorimin dhe riciklimin është një e mirë për të ardhmen e vendit tonë.

Aktivitetet ndërgjegjësuese do të vijojnë dhe në bashkitë e tjera të vendit tone



Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pjesë e Rrjetit Europian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (EIONET), Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA)



Agjencia Kombëtare e Mjedisit prej vitesh është anëtare e EIONET, rrjetit më të madh dhe të vetëm të këtij lloji në Europë, të ngritur nga Agjencia Europiane e Mjedisit. Në këtë kuadër ajo bashkëvepron ngushtë me këtë institucion ndërkombëtar mjedisor, duke shkëm-

byer informacion dhe të dhëna mjedisore mbi gjëndjen e mjedisit në Shqipëri, merr pjesë në aktivitete dhe seminare rregullisht, nëpërmjet rrjetit të saj kombëtar të NRC (National Reference Centers për tematika dhe fusha të caktuara të mjedisit, jep kontributin e saj në çështje që lidhen me përbushjen dhe zbatimin e aktiviteteve, projekteve dhe programeve të mbështetjes për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërinë si pjesë e tij, si dhe përfiton në nivel forcimi kapacitetesh dhe asistence teknike nga kjo agjenci.

Në kuadër të angazhimeve dhe përbushjes së tyre nga AKM, gjatë muajve të fundit të vitit 2020, janë finalizuar disa iniciativa dhe aktivitete të rëndësishme, të cilat e forcojnë dhe e cojnë një hap përpara bashkëpunimin institucional mes dy institucioneve.

Për herë të parë, AKM gjatë vitit 2020 ishte anëtare në Troiken e NFP EIONET/ EEA krahas, Irlandës, Sllovakisë, Lituaniës dhe Maltës, duke përfunduar në mënyrë serioze dhe mjaft profesionale e përbushur gjithë angazhimet e detyrat e parashikuara për anëtarët e kësaj strukture, krahas vendeve anëtare.



Rrjeti kombëtar i NFP/NRC-ve kanë marrë pjesë rregullisht në aktivitetet online të organizuara në nivel europian nga EEA, për tematika mjedisore të lidhura me: cilësinë e ajrit, ujërave, menaxhimin dhe monitorimin e ujërave bregdetarë larës, ndryshimet klimatike dhe zbutjen e adaptimin e efekteve të tyre, përmirësimin e sistemeve të informacionit mjedisor, mbetjet, biodiversitetin dhe pyjet etj. Vetëm në gjashtë muajt e fundit janë organizuar rreth 50 takime online, në të cilat është marë pjesë edhe nga Rrjeti Shqiptar EIONET, pjesë e EEA-së.

Për herë të parë në historinë e bashkëpunimit ndër institucional AKM-EEA dhe pas një periudhe gati tre vjecare negociimi me EEA dhe KE, u finalizua me sukses Mareveshja e Bashkëpunimit të EEA me AKM duke e ngritur në një tjetër nivel bashkëpunimin mes këtyre institucioneve dhe vendosur mbi baza me konkrete angazhimin mes paleve.




Ky dokument i rëndësishëm u miratua gjatë mbledhjes së 90-të të Bordit Menaxhues të EEA, e cila është struktura më e lartë vendimarrëse e këtij institucioni, më 10 Dhjetor 2020. Në Bord për herë të parë në cilësinë e anëtarit vëzhgues mori pjesë dhe Z. Edison Konomi, si Drejtues i AKM, për Shqipërinë.

Agjencia Europiane e Mjedisit për vitin 2021, ka publikuar Programin e Punës, i cili është miratuar nga KE ku një rol dhe vend të qartë e të vecantë luan edhe aktiviteti dhe axhenda e saj me vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila jo vetem që do të vazhdojë por do të intensifikohet edhe me tej.

Përparësitë e aplikimit on-line për procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Aplikimi në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për procedurat e VNM-së, bëhet fizikisht në rrugë postare. Për lehtësimin e procedurave është kërkuar ndryshimi i kuadrit ligjor, që përfshin edhe mënyrën e aplikimit.


Në këtë kuadër, u miratua VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar dhe doli Urdhëri i Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020".



Është punuar në bashkëpunim me AKSHI-n, që aplikimi të bëhet nëpërmjet një sistemi elektronik, i cili do të lidhet direkt me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Ky sistem i ri i aplikimit të VNM-ve on-line, u testua duke marrë dhe dhënë asistencë dhe tani e gjithë procedura e VNM-së kryhet on-line. I gjithë procesi që nga aplikimi, shqyrtimi dhe dhënia e vendimit përkatës, kryhet nëpërmjet këtij sistemi, i cili ka këto përparësi:

- Thjeshtimin e procedurave për biznesin
- Thjeshtimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e vendimit
- Krijimin e një baze të dhënash (regjistër elektronik) për të gjitha procedurat e kryera dhe dhëniet e vendimeve përkatëse
- Shkurtimin e afateve të shqyrtimit dhe daljes së vendimit
- Zhvilluesi ndjek on-line në kohë reale dhe në mënyrë transparente të gjithë procedurën e dosjes së aplikuar për projektin e propozuar.

Në zbatim të këtij sistemi janë pajisur me nënshkrim elektronik të gjithë nëpunësit e përfshirë në procesin e aplikimit në sistemin e-leave për procedurën on-line të VNM-së si dhe në sistemin e SQDNE-së (në nivel qendror dhe rajonal).



Rëndësia e monitorimit të cilësisë së ujërave

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara. Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare si dhe ndikimin e shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e tyre përkatësisht:

- 38 stacione në lumenjtë kryesorë të vëndit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë.
- 3 stacione për tributarët e liqenit të Ohrit
- 10 stacione në liqenet natyralë, Ohër, Shkodër, Prespë, Prespë e Vogël dhe laguna e Butrintit
- 14 stacione në ujërat e zonës bregdetare në qytetet Durrës, Vlorë, Sarandë, Shëngjin dhe Velipojë.
- 4 stacione lagunore në Lagunën e Karavastasë dhe Nartë.

Për herë të parë në programin e monitorimit të vitit 2019 është shtuar monitorimi i cilësisë së statusit kimik për bregdetin Jon Dhërmi, Himarë, Borsh, Lukovë, Ksamil dhe Zvërnec.

Treguesit që monitorohen:

- Për stacionet **lumore**:
temperatura, pH, alkalitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO₅, nitritet, nitratet, amoniaku, P_{total}, PO₄, lënda pezull
- Për stacionet **liqenore**:
temperatura, pH, alkalitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO₅, nitritet, nitratet, amoniaku, P_{total}, PO₄, lënda pezull, klorofila a

- Për stacionet e **zonave bregdetare**

temperatura, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO₅, nitritet, nitratet, amoniaku, P_{total}, PO₄, lënda pezull



Vlerësimi paraprak i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara

të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Ndërsa për klasifikimin e zonave bregdetare dhe stacionet pranë impianteve të trajtimit të ujërave të zeza i referohemi VKM 177 dt. 31.03.2005 - Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit.

Qëllimi i monitorimit është përcaktimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore, lumenj, liqene dhe zona bregdetare. Ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e ujërave sipërfaqësore. Krijimi i bazës së të dhënave të cilësisë së ujërave sipërfaqësore si dhe raportimi i të dhënave në Agjencinë Europiane të Mjedisit.



Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është në dobi të gjithë qytetarëve në mënyrë që të njihen mbi gjendjen e cilësisë së ujërave në zonat ku jetojnë. Identifikon ndikimin e aktivitetit njerëzor në cilësinë e ujërave si dhe masat që i adresohen organeve të qeverisjes për përmirësimin e cilësisë së tyre.

Nga monitorimi për periudhën Shkurt- Qershor duke vlerësuar të gjithë parametrat e Direktivës Kuadër të Ujit rezulton se cilësia e ujërave të lumenjve të:

- Basenit të Drinit i përket Klasës III – Gjendje e moderuar.
- Basenit të Matit klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë.
- Baseni Ishëm – Erzen, në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajuara sjell klasifikim me një ndotje të lartë.
- Basenit të Shkumbinit renditet në Klasën II – Gjendje e mire.
- Basenit të Vjoses klasifikohen si ujëra me cilësi të mirë.
- Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën II- gjendje e mirë

Synimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit

Me riskstrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është krijuar Sektori i Kërkimit, Analizës dhe Bashkëpunimit Shkencor, i cili ka hartuar Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2021. Ky program ka për qëllim grumbullimin sistematik të informacionit i cili synon vrojtimin e gjendjes së mjedisit për treguesit e mjedisit që përfshijnë:

- Cilësinë e ajrit, menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujërave (shpërndarja dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane), mbrojtjen e natyrës, biodiversitetin, infrastruktura e gjelbër, ndotjen industriale, zhurmat, kimikatet si dhe ndryshimet klimatike



Njohja me cilësinë e mjedisit, me synim marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes si dhe të ndihmojë autoritetet kombëtare dhe vendimarrësit për të arritur qëllimet e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Prej këtyre të dhënave të monitorimit vlerësohet se sa kanë qenë të frytshme politikat dhe masat e ndërmarra për cilësinë e mjedisit, për menaxhimin e burimeve natyrore nga ana e njeriut në një zone të caktuar. Ky program është i lexueshëm në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Teknologjitë më të Mira të Disponueshme

Kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është dhe hartimi i “Teknikave më të mira të Disponueshme”, si pjesë e kornizës rregullatore për të parandaluar dhe kontrolluar emetimet industriale. Këto teknika sigurojnë, mjetet dhe praktikatat përkatëse se si të identifikojnë dhe vendosin nivelet e emetimit të TMD-ve, dhe nivele të tjera të performancës mjedisore, kushtet e lejes, përfshirë vlerat kufitare të emetimit.



Faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e një aktiviteti dhe metodat e saj të funksionimit, të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar, në parim, bazën për vlerat kufitare të emetimit, në

rastin e një veprimtarie lidhur me emetimet industriale Gjithashtu përcaktojnë kushte të tjera shtesë të liçencës, të krijuara për të parandaluar apo eliminuar ose, kur kjo nuk është e praktikueshme, përgjithësisht për të zvogëluar një emision dhe ndikimin e tij në mjedis si dhe sektorët e ndryshëm industrial, në të cilën ushtrohet një veprimtari e cila ka ndikim në mjedis.

Monitorimi i zhurmave urbane

Monitorimi i zhurmave urbane kryhet sipas Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, në 43 pika monitorimi në qytetet kryesore të vendit tonë si Tiranë, Vlorë, Fier, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Kukës dhe Lezhë, për një kohë matje 24 orëshe dhe niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën, llogaritet nga ora 06⁰⁰ - 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰ - 06⁰⁰.

Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegullës dhe borës, shpejtësia e erës nuk duhet të jete më e lartë se 5 m/s, mikrofoni i mbrojtur me kufje anti-erë. Zinxhiri i matjeve duhet të jetë në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.

Vlerat mesatare e nivelit të zhurmave të qyteteve të monitoruara për periudhën 6 mujore të vitit 2020 për Ditën dhe Natën paraqiten si me poshte:

	Laeq Ditën	Laeq Naten
Tirana	58.90	54.38
Vlore	60.9	51.61
Lezhe	62.9	47.02
Sarande	59.9	48.8
Pogradec	55.52	45
Fier	59.08	50.59
Kukes	54.1	41.35
Gjirokastrer	57.13	50.47
Korce	58.57	50.27
Berat	56.15	48.15
Shkoder	62.9	52.45
Norma	55	45

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave gjatë ditës, vërejmë se kemi tejkalimin të normës ditën (55 dB) në të gjitha qytetet me përjashtim të Kukësit ku niveli i zhurmave është më i ulët se norma

Niveli më i lartë i zhurmave është monitoruar në stacionet e Lezhës dhe Shkodrës ku kemi tejkalim të normës me 14.4% dhe 10.7%. Nivelet më të ulëta janë monitoruar në stacionet e Pogradecit ku kemi tejkalim afërsisht 1% dhe Kukësit ku vlera është 1.6% më e ulët.



Nga të dhenat e monitoruara natën vërejmë tejkalimin më të lartë të normës natën (45 dB) në të gjitha qytetet me përjashtim të qytetit të Kukësit. Niveli më i lartë është monitoruar në stacionet e Tiranës me 20.8% dhe Shkodrës me 16.5%, Nivelet më të ulëta janë monitoruar në stacionet e Pogradecit ku vlera e monitoruar është e barabartë me normën dhe në stacionet e Kukësit ku niveli i zhurmave është më i ulët se norma 8%. Gjenerimi i zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut si dhe në mjedis dhe për këtë duhen marrë masa mbrojtëse për zvogëlimin e nivelit të zhurmave në mjedis nëpërmjet ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Aktiviteti njerëzor dhe performanca mjedisore

Një sektor i krijuar rishtazi, pranë AKM-së, është edhe sektori i Performancës dhe Objektivave Mjedisore. Si një nga qëllimet kryesore të vetë funksionimit të Agjencisë, ne synojmë të rrisim vëmendjen e të gjithë institucioneve publike, jopublike, organizatave joqeveritare, grupeve të interesit, deri te qytetarët e thjeshtë, për rëndësinë që ka mjedisi dhe si ndikon gjithësecili prej nesh në ruajtjen, përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.



Në bazë të kriterëve dhe standarteve të përcaktuara, praktikave më të mira të Bashkimit Europian, janë bërë disa aktivitete dhe takime edukuese, në të gjithë Shqipërinë, për monitorimin, grumbullimin e të dhënave dhe informacionin mjedisore, duke shpjeguar dhe analizuar se si ndikojnë veprimtaritë e gjithë secilit prej nesh, në gjëndjen e mjedisit, dhe si mund të përmirësojmë situatën. Disa nga pikat ku jemi mbështetur janë:

- Si ndikojnë emetimet e shkaktuara nga mjetet e transportit?
- Qëndrueshmëria-Performanca dhe Indikatorët e Performancës
- Mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi eficient i burimeve të saj

Takime me Agjencine Suedeze te Kimikateve

Bazuar në kërkesat e Ligjit 27/2016 të datës 17.3.2016 "Për menaxhimin e kimikateve", nën projektin "Për mbështetjen e Ministrisë së Turizmit dhe Ambienti për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve", me ndihmën e ekspertëve nga Agjencia Suedeze e Kimikateve (KEMI), gjatë vitit 2020, janë realizuar takime për njohjen me situatën aktuale të kimikateve identifikimin e nevojave në këtë fushë dhe mbështetjen teknike në lidhje me Sektorin e ri të Kimikateve, në Drejtorinë e Dijes dhe Kërkimit Mjedisor, krijuar në korrik 2020 në strukturën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Inspektimi dhe Kontrolli Mjedisor

Misioni i Drejtorisë së Inspektimit dhe Kontrollit (DIK) është garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse. Inspektimi dhe kontrolli synon :

- ✚ Identifikimin e rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimeve nga aktivitetet e paligjshme;
- ✚ Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet;
- ✚ Vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësime që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së AKM;

Metodologjia e aplikuar mbështetet në praktikën e mëparshme të hartimit të raporteve dhe të përditësuar me ndryshimet e reja, raportet e inspektimit të cilat kryhen on-line, si një proces i rregullt administrativ, pasqyrimin të indikatorëve të inspektimit, si dhe zbatimin të Rekomandimeve të Parlamentit Europian 2001/331/EC "Për kriteret minimale të inspektimeve" të transpozuar në legjislacionin e posaçëm.

Gjatë procesit të inspektimeve kërkohet të raportohen gjetjet dhe problematika në lidhje me:

- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese.
- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve që shfrytëzojnë burimet natyrore, në mënyrë të vecantë gurorët, minierat dhe subjektet me aktivitet shfrytëzimi të naftës dhe gazit.
- Parandalimin e ndotjes akustike nga aktivitetet që gjenerojnë ndotje akustike në mjedis.
- Parandalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të pa trajtuara në burimet ujore pritëse, sidomos gjatë sezonit turistik.

Kryesisht gjetjet dhe problematikat që dalin nga inspektimet janë të lidhura me mospëmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në lejet mjedisore në raport me;

- ✚ cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
- ✚ cilësinë e ujërave nëntokësore;
- ✚ cilësinë e ajrit;
- ✚ menaxhimin e mbetjeve;
- ✚ zhurmat;
- ✚ cilësinë e tokës.

Gjithashtu kjo drejtori siguron të dhëna të informatizuara (ose jo) nëpërmjet sistemit unik të inspektimit për të patur informacion për të gjithë aktivitetin e saj, si dhe të dhëna për subjektet (gjurmueshmëria) duke :

- Siguruar sistemin e raportimit të incidenteve / ngjarjeve për të gjitha fushat e kuadrit që mbulon specifikisht legjislacioni mjedisor, duke bërë të mundur identifikimin e hershëm të problemeve dhe shpërndarjen në kohë të burimeve të inspektimit dhe masat korrigjuese.
- Siguruar rrjedhje në kohë të informacionit për menaxhimin e veprimtarisë së DIK.

Gjatë një periudhe 6-mujore janë arritur objektivat e mëposhtme:

- Përmirësimi i metodës së raportimit të sistemit për incidentet dhe procesin e shqyrtimit,
- Inicuar zbatimin e një procesi të kryerjes së efektshme të çështjeve dhe zhvillimin e një menaxhimi elektronik sipas Portalit Unik "e-inspektimi" për të përmirësuar përputhjen me procedurat e dokumentuara të inspektimit.
- Përmirësimi i menaxhimit për të siguruar vazhdimësi në detyrë për inspektimin.
- Informatizimi i ndjekjes së problematikës sipas sistemit unik elektronik.
- Konkretizim për raportimin e parregullsive, të mashtimit dhe incidenteve duke respektuar kuadrin ligjor, duke orientuar drejt zgjidhjeve të drejta të ankesave.
- Krijuar një hapësirë e posaçme për trajtimin e apeliemeve/shqyrtimeve ndaj masave administrative dhe gjobave të vendosura ndaj subjekteve, në kuadër të aplikimit të përgjegjësisë mjedisore.
- Reduktuar ndjeshëm numri i ditëve të inspektimit, si pasojë e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku dhe kontrolle tematike për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.
- Garantimi i një procesi inspektimi të rregullt e transparent, i cili shton besimin e publikut dhe bizneseve të strukturat shtetërore

Përfshirja e vetëmonitorimit në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, nëpërmjet Nenit 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit e të ndikimeve të rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore.

Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetëmonitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore.

Mbi bazën e këtij ligji zhvilluesi ka detyrimet që edhe për procedurat e VNM-ve, pas pajisjes me aktin e miratimit, **të sjellë pranë AKM-së informacionet e mëposhtme** duke shtuar në këtë mënyrë kushtet e monitorimeve për procedurat e VNM-ve.

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

Mbështetja e AKM në zbatimin e Projektit IPARD-II

Në mbështetje të ligjit Nr. 37/2015 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për rregullat e mbështetjes financiare të BE për Shqipërinë dhe në kuadër të instrumentit për Asistencën e Para Antarësimin në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”, IPARD II, Programin për Zhvillimin Rural 2014-2020, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesë e grupit të institucioneve për zbatimin e këtij programi.

Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ngriti grupin teknik të punës i cili do të kryente verifikimin në terren dhe konfirmimin e përmbushjes së standarteve mjedisore kombëtare dhe ato të Bashkimit Europian të veprimtarive që mbulohen nga projekti IPARD-II.

Grupi teknik i punës gjate periudhes Korrik –Dhjetor 2020 ka kontrolluar në terren, të gjitha investimet e kryera nga fermerë dhe biznese që janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratë me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe ka konfirmuar përmbushjen e standarteve mjedisore kombëtare dhe ato të Bashkimit Europian, duke pajisur me çertifikatën e plotësimit të standarteve mjedisore kombëtare dhe ato të Bashkimit Europian të 76 subjekteve dhe bizneseve të mëposhtme:

Nr	Lloji i biznesit	Numri i subjekteve
1	Traktorë dhe agregate bujqësore	25
2	Sera diellore për kultivimin e perimeve	12
3	Pika për grumbullimin e frutave dhe perimeve	9
4	Industria e përpunimit të mishit	4
5	Industria e përpunimit të qumështit	2
6	Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve	4
7	Mbjellja e blloqeve frutore dhe vreshtave	7
8	Në sektorin e agro-turizmit	6
9	Në sektorin e mbarështimit të blegtorisë	7